



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.76

2005

24 tetor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9421
datë 29.9.2005

Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 11.9.2005 të Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse në stërvitjen “Cooperative Engagement 05” dhe zhvillimin e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare të drejtuar nga NATO, “Cooperative Engagement 05”, me pjesëmarrjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë”.....

2515

Ligj nr.9422
datë 29.9.2005

Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për asistencë financiare”.....

2524

LIGJ
Nr.9421, datë 29.9.2005

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR.1, DATË 11.9.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPE (SHAPE), LIDHUR ME DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË VENDIT PRITËS PËR FORCAT PJESËMARRËSE NË STËRVITJEN “COOPERATIVE ENGAGEMENT 05” DHE ZHVILLIMIN E STËRVITJES USHTARAKE NDËRKOMBËTARE TË DREJTUAR NGA NATO, “COOPERATIVE ENGAGEMENT 05”, ME PJESËMARRJEN E FORCAVE TË HUAJA USHTARAKE NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 12, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 11.9.2005 të Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës për forcat pjesëmarrëse në stërvitjen “Cooperative Engagement 05” dhe zhvillimin e stërvitjes ushtarake ndërkombëtare të drejtuar nga NATO, “Cooperative Engagement 05”, me pjesëmarrjen e forcave të huaja ushtarake në territorin e Republikës së Shqipërisë”.

Shpallur me dekreten nr.4670, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMANDËS SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPE (SHAPE), LIDHUR ME DISPOZITAT E MBËSHTETJES SË VENDIT PRITËS PËR FORCAT PJESËMARRËSE PËR STËRVITJEN “COOPERATIVE ENGAGEMENT 05”

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), këtu e në vazhdim të quajtura Palë,

duke mbajtur parasysh dispozitat e Traktatit të Atlantikut të Veriut të 4 prillit 1949, dhe në veçanti nenin 3, të zbatueshme për Palët në këtë Traktat;

duke pasur parasysh dispozitat e marrëveshjes mes palëve në Traktatin e Atlantikut të Veriut lidhur me statusin e forcave të tyre (NATO-SOFA) të 19 qershorit 1951;

duke pasur parasysh Dokumentin Kuadër të Partneritetit për Paqe të kryetarëve të shteteve dhe qeverive, pjesëmarrëse në takimin e Këshillit të Atlantikut të Veriut (Dokumenti Kuadër) të 10 janarit 1994;

duke pasur parasysh dispozitat e marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, lidhur me statusin e forcave të tyre (PfP SOFA) të 19 qershorit 1995;

duke pasur parasysh dispozitat e protokollit për statusin e Shtabeve Ushtarake Ndërkombëtare të ngritura në përputhje me Traktatin e Atlantikut të Veriut (Protokolli i Parisit), të 28 gushtit 1952;

duke pasur parasysh dispozitat e protokollit tjetër shtesë të marrëveshjes ndërmjet shteteve palë të Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe, lidhur me

statusin e forcave të tyre (protokolli tjetër shtesë) të 19 dhjetorit 1997;

duke pasur parasysh konceptin e stërvitjeve dhe operacioneve të parashikuara të kryhen me NATO-n, Partneritetin për Paqe (PfP) dhe forca të tjera të NATO-s;

duke konsideruar se stërvitja Cooperative Engagement 05 (stërvitja) do të zhvillohet në territorin e Republikës së Shqipërisë, më 12 deri më 23 shtator 2005 dhe që vende të NATO-s dhe vende të PfP-së do të marrin pjesë në stërvitje;

duke konsideruar që Komanda Supreme e Forcave të Aleancës në Europë është një komandë strategjike në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut, përgjegjëse për drejtimin e stërvitjes “Cooperative Engagement 05”;

duke pasur në vëmendje dëshirën për procedura uniforme të zbatueshme për forcat pjesëmarrëse të vendeve të NATO-s dhe vendeve të PfP-së në drejtimin e stërvitjes;

duke njohur nevojat e pjesëmarrësve dhe të vendeve dërguese të mbështeten logjistikisht nga vendi pritës, me qëllim lehtësimin e stërvitjes, kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm.

Neni 1 Përkufizime

Për qëllim të këtij memorandum mirëkuptimi (MM), termat e mëposhtëm kanë kuptimet si u janë caktuar më poshtë:

1.1 “Forca” - Nënkupton gjithë përbërësit e NATO-s, e forcës së NATO-s, duke përfshirë personelin, kafshët, materialet dhe dispozitat, së bashku me komponentët civilë të këtyre forcave, siç përcaktohet në NATO SOFA, PfP SOFA, Protokollin e Parisit dhe në protokollin tjetër shtesë të PfP SOFA-s. Ky term, gjithashtu përfshin gjithë anijet, avionët, automjetet, sistemet e komunikimit, depot, pajisjet, rezervat dhe municionin, si dhe burimet për lëvizjen ajrore dhe detare, së bashku me shërbimet e tyre mbështetëse, përfshirë kontraktorët, të kërkuar për dislokimin ose mbështetjen e forcave.

1.2 “Komandanti i NATO-s” - Një komandant ushtarak në zinxhirin e komandimit të NATO-s.

1.3 “Shtabet ndërkombëtare” - Shtabet ushtarake ndërkombëtare në strukturën e integruar të NATO-s. Përfshihen veprimtari që mund të jenë detashmente ose njësi të përkohshme të shtabeve.

1.4 “Shtabet kombëtare” - Shtabet ose forcat kombëtare në komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.5 “Shtabet shumëkombëshe” - Shtabet me personel nga më tepër se një komb, të formuara me marrëveshje të vendeve pjesëmarrëse dhe nën komandën dhe kontrollin e NATO-s.

1.6 “Vendi pritës (VP)” - Republika e Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes.

1.7 “Mbështetja e vendit pritës (MVP)” - Asistenca civile dhe ushtarake që u jepet, nga vendi pritës, forcave që janë të dislokuara në territorin, ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore të vendit pritës për qëllime të stërvitjes.

1.8 “Shpenzimet” - Shpenzimet që lidhen me mbështetjen dhe ruajtjen e shtabeve kombëtare, shumëkombëshe ose shtabet ndërkombëtare, forcat ose formacionet. Për qëllime të këtij memorandum mirëkuptimi dhe dokumenteve që do ta pasojnë:

1.8.1 Shpenzimet e përbashkëta të NATO-s - Shpenzimet e pranura më parë si përgjegjësi kolektive e Aleancës.

1.8.2 Shpenzime të ndara - Shpenzimet e pranura më parë të jenë përgjegjësi e ndarë në më tepër se një shtet. Rregullimet për shpenzimet e ndara do të bazohen në një formulë të pranuar nga pjesëmarrësit.

1.8.3 Kosto kombëtare direkt - Shpenzimet e konsideruara të jenë përgjegjësi e një shteti të vetëm.

1.8.4 Fonde të përbashkëta të NATO-s - Fondet e siguruar nga vendet e NATO-s, përmes SHAPE-s për mbulimin e shpenzimeve të përbashkëta, që ndodhin gjatë drejtimit të kësaj stërvitjeje.

1.9 “Rajoni i stërvitjes” - Ky rajon përfshin zonën e trajnimit, së bashku me ujërat territoriale dhe të brendshme të Shqipërisë, siç përcaktohet në marrëveshjen teknike.

1.10 “Vende dërguese (VD)” - Vendet që dërgojnë forca jashtë territorit të vendit të tyre për të marrë pjesë në stërvitje.

1.11 “Marrëveshje teknike” - Marrëveshje në vazhdim të këtij memorandum mirëkuptimi që do të zhvillojë dhe specifikojë procedurat dhe aspektet teknike për dispozitat e MVP-së.

1.12 “Klerancë e përgjithshme” - Do të thotë një kuadër i lejeve të kërkuara, në përputhje me legjislacionin e vendit pritës për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e forcave të vendeve dërguese për në/nga territori i vendit pritës dhe drejtimin e operacioneve për qëllim të drejtimit të stërvitjes, në përputhje me dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi.

Neni 2

Qëllimi

2.1 Qëllimi i këtij memorandum mirëkuptimi është të përcaktojë politikat dhe procedurat për dispozitat e MVP-së nga vendi pritës, forcës gjatë stërvitjes.

2.2 Ky memorandum mirëkuptimi dhe dokumentet që do ta pasojnë kanë si qëllim të shërbejnë si bazë për planifikimin nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë dhe nga komandantët e NATO-s të MVP-së për stërvitjen.

Neni 3

Fushat dhe angazhimet e përgjithshme

3.1 Dispozitat e NATO SOFA-s, Protokollit të Parisit dhe Pfp SOFA-s, si dhe të protokollit tjetër shtesë të Pfp SOFA-s do të zbatohen për të gjitha operacionet mbështetëse të nevojshme për stërvitjen dhe të zbatueshme sipas këtij memorandum mirëkuptimi. Vendi pritës njihet që vendndodhja operationale dhe logjistike e vendosur për zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi, janë detashmente të SHAPE-s dhe veprimtaritë e këtyre detashmenteve janë të ndërmarra nga SHAPE. Vendndodhja do të caktohet në dokumentet pasuese të këtij memorandum mirëkuptimi. Rregullimet e komandë-kontrollit do të caktohen në planet e stërvitjes që do të zbatohen.

3.2 Ky memorandum mirëkuptimi do të jetë në përputhje me politikën dhe doktrinën e NATO-s (MC 334/1 dhe AJP 4.5) dhe siguron një mbrojtje dhe strukturë për MVP-në, për hyrjen e shpejtë të forcave të NATO-s dhe autorizimin e vendit pritës për dislokimin e forcës në territorin e vendit pritës dhe zbatimin efektiv të stërvitjes.

3.3. Ky memorandum mirëkuptimi parashikohet të jetë në harmoni me ligjet e vendit pritës dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që mund të zbatohen.

3.4. Pas miratimit të këtij memorandum mirëkuptimi midis SHAPE-s dhe vendit pritës, do të ftohen vendet dërguese të pranojnë dispozitat e këtij memorandum mirëkuptimi përmes një njoftimi pranimit ose deklarate qëllimi.

3.5. Stërvitja, e mbështetur nga ky memorandum mirëkuptimi, do të kërkojë mbështetje logjistike shumëkombëshe për operacionet ajrore, përmes avionëve dhe helikopterëve me krahë të fiksuar dhe, në rast të porteve, përmes anijeve private ose ushtarake. Vendi pritës ka dijeni se lëvizja e këtyre avionëve, helikopterëve, anijeve dhe ekuipazhit të tyre në territorin shtetëror të vendit pritës, do të kryhet në bazë të një lejeje të përgjithshme për kohëzgjatjen e operacionit. Vendi pritës do të kontrollojë të gjitha aspektet e kësaj lejeje në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Dokumente të zbatueshme

Dokumentet e zbatueshme për këtë memorandum mirëkuptimi janë përfshirë në aneksin A.

Neni 5

Përgjegjësitë

5.1 Vendi pritës

5.1.1 Vendi pritës jep pëlqimin për dislokimin dhe prezencën e forcës në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllim të stërvitjes dhe në vazhdim të stërvitjes.

5.1.2 Vendi pritës do të sigurojë mbështetje siç detajohet në dokumentet pasuese të këtij memorandum mirëkuptimi. Mangësitë në madhësinë ose llojin e mbështetjes së parashikuar gjatë zbatimit praktik të mbështetjes së planifikuar do të identifikohen me bisedime.

5.1.3 Vendi pritës do të sigurojë mbështetjen e kërkuar logjistike dhe shërbimet siç është rënë dakord mes pjesëmarrësve të këtij memorandum mirëkuptimi dhe siç është pranuar nga vendi pritës dhe vendet dërguese në marrëveshjet teknike, që mund të përfundohen për qëllim të vazhimit të drejtimit të stërvitjes.

5.1.4 Në mënyrë që të sigurojë mbështetjen e pranuar, vendi pritës do të lehtësojë procedurat e nevojshme me burime mbështetëse, duke përfshirë burime civile dhe tregtare.

5.1.5 Vendi pritës do të sigurojë vlerat e shpenzimeve 30 ditë përpara për shërbimet që do t'i sigurohen vendit pritës dhe vendi pritës do të mbajë të dhënat administrative e financiare të nevojshme për rimbursimin vendit pritës, të shërbimeve të siguruar për forcat. Të dhënat që dokumentojnë transaksionet e financuara nga buxhetet e NATO-s do t'i jepen NATO-s kur kërkohen për qëllim kontrolli. Faturat duhet të përkthehen në gjuhën angleze.

5.1.6 Vendi pritës do të marrë të gjitha masat e nevojshme brenda mundësive të tij për të lehtësuar lëvizjen e forcës në rrugë, hekurudhë, aeroport ose porte, së bashku me automjetet, anijet, avionët dhe pajisjet e forcës nga pika e hyrjes për në/dhe nga pritja, përqendrimi, dislokimi dhe rajonet e stërvitjes.

5.1.7 Vendi pritës do të autorizojë personelin e forcës të mbajë armë dhe municion gjatë stërvitjes në kohën dhe vendin siç do të përcaktohet midis vendit pritës dhe autoriteteve ushtarake të NATO-s dhe vendeve dërguese. Kjo do të jetë në përputhje me masat e mbrojtjes së forcës. Rregullimet e hollësishme për mbajtjen e armëve do të parashikohen në dokumentet pasuese të këtij memorandum mirëkuptimi.

5.1.8 Vendi pritës do t'i sigurojë forcës mbështetje mjekësore dhe dentare nga personeli ushtarak dhe lehtësirat e vendit pritës, në të njëjtat kushte si personelit ushtarak të vendit pritës.

5.1.9 Vendi pritës do ta njohë forcën me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe rregullat lidhur me fushat e mëposhtme:

- a) Mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e natyrës;
- b) Shkatërrimi i produkteve të rrezikshme dhe municionit;
- c) Llojet e armëve dhe rajonet e stërvitjes;
- d) Procedurat në raste aksidentesh automobilistike;
- e) Procedurat e rregullat e municioneve, përfshirë magazinimin dhe shkatërrimin;
- 1) Procedimi penal;
- g) Rregullat dhe procedurat doganore;
- h) Trafikun detar;
- i) Trafikun ajror.

Ky informacion do të jepet të paktën 45 ditë përpara fillimit të stërvitjes. Gjithashtu, të paktën 45 ditë përpara fillimit të stërvitjes, vendi pritës do t'i sigurojë forcës një përmbledhje të historisë, zakoneve e traditave kulturore për aq sa ato lidhen me drejtimin e stërvitjes dhe forcën.

5.1.10 Vendi pritës do të sigurojë shërbime dhe mbështetje shtesë nga burimet tregtare vetëm kur kjo kërkohet nga autoritetet kompetente të NATO-s ose të vendeve dërguese.

5.2 SHAPE (ose komandanti i NATO-s):

5.2.1 Do të sigurojë, në maksimumin e mundshëm, që ky memorandum mirëkuptimi dhe dokumentet mbështetëse do të specifikojnë tipin, masën dhe cilësinë e mbështetjes së kërkuar për drejtimin e suksesshëm të stërvitjes dhe do të sigurojnë informacion shtesë të nevojshëm për planifikimin e vendit pritës, sa më shpejt të jetë e mundur.

5.2.2 Do të njoftojë në kohë për çdo ndryshim në rrethanat e vendit pritës dhe do të propozojë ndryshime të këtij memorandum mirëkuptimi dhe dokumenteve mbështetëse, nëse nevojiten.

5.2.3 Do të identifikojë MVP-në e kërkuar dhe do të miratojë çmimet për shpenzimet e përbashkëta. Në rast të kërkesave konfliktuese, prioritetet do të përcaktohen nga SHAPE ose komandanti i NATO-s.

5.2.4 Do të sigurojë rimbursimin financiar për vendin pritës për MVP-në e pranuar, nëse është paguar përmes financimit të përbashkët. Në të gjitha rastet e tjera, SHAPE ose komandanti i NATO-s do të ndihmojë aq sa është e mundur në zgjidhjen e detyrimeve financiare midis vendit pritës dhe vendeve dërguese.

5.2.5 Do të përcaktojë nëse financimi i përbashkët është i vlefshëm dhe cilat kërkesa janë të vlefshme për financimin e përbashkët.

5.2.6 Nëse kërkesat e vendeve dërguese janë në konflikt me prioritetet e shpërndarjes së burimeve të komandantit të NATO-s, do të zgjidhë konfliktin me vendet dërguese të përfshira.

5.2.7 Do të lehtësojë standardizimin e kërkesave të mbështetjes dhe shpenzimeve gjatë negociatave.

5.2.8 Do të drejtojë stërvitjen dhe do të përdorë lehtësirat e vendit pritës në përputhje me Rregullat Operacionale të Stërvitjes (EXOPORD) dhe dokumente dhe procedura të tjera të stërvitjes.

5.3 Vendet dërguese:

5.3.1 Do të respektojnë ligjet e vendit pritës në përputhje me nenin II të PfP SOFA-s dhe do të shmangin veprimet e papranueshme në kuadër të PfP SOFA-s, duke pasur parasysh kulturën, zakonet dhe traditat e popullsisë së vendit pritës.

5.3.2 Do të drejtojnë stërvitjen dhe do të përdorin lehtësitë e vendit pritës, në përputhje me

procedurat dhe dokumentet pasuese të stërvitjes.

5.3.3 Do të sigurojnë pajisjet e nevojshme teknike dhe operacionale për forcën, nëse nuk është siguruar nga ky memorandum mirëkuptimi dhe/ose ndonjë marrëveshje teknike.

5.3.4 Do të jenë përgjegjëse për kostot e të gjitha shërbimeve mjekësore dhe dentare civile të kryera nga vendi pritës.

5.3.5 Do të rimburojnë vendin pritës për të gjitha shërbimet dhe mbështetjen e kërkuar dhe do të marrë, në përputhje me parimet e përkufizuara në seksionin 6 të këtij memorandum mirëkuptimi.

5.3.6 Do të zbatojnë rregullat dhe procedurat mjedisore që janë në fuqi për mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit, si dhe ligjet shqiptare në lidhje me kërkesat mjedisore; humbjen e produkteve, koleksionin dhe lëvizjen; magazinimin, lëvizjen dhe shkatërrimin e materialeve të rrezikshme dhe municioneve për në, nga dhe brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Vendet dërguese do të vëzhgojnë të gjitha kufizimet lidhur me përdorimin e pasurive natyrore të mbrojtura.

5.3.7 Do të identifikojnë kërkesat e MVP-së vendit pritës dhe komandantit të NATO-s.

5.3.8 Do të raportojnë ndryshimet në kërkesat e MVP-së, të vendit pritës dhe komandantit të NATO-s, sapo ato ndodhin dhe do të paraqesin kërkesa të rishikuara të MVP-së.

5.3.9 Mund të zgjedhin të marrin pjesë në strukturën dhe procedurat për MVP-në, përmes miratimit të këtij memorandum mirëkuptimi ose duke nxjerrë një deklaratë qëllimi.

Neni 6

Çështje administrative

6.1 Hyrja dhe dalja e anëtarëve të forcës në dhe nga territori i Republikës së Shqipërisë do të bëhet në përputhje me nenin 3 të NATO SOFA-s.

6.2 Importi dhe eksporti i pajisjeve dhe sasive të arsyeshme të rezervave ushqimore, pajisjeve dhe mallrave të tjera për përdorim ekskluziv të forcës brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë do të kryhet në përputhje me nenin 11 të NATO SOFA-s, rregullat shqiptare dhe procedurat doganore. Për import-eksportin e përkohshëm, NATO dhe vendet dërguese do të zbatojnë dokumentet doganore të siguruara nga vendi pritës.

6.3 Në përputhje me nenin 11 paragrafi 4 i NATO SOFA-s, sasitë e arsyeshme të mallrave, pajisjeve, rezervave ushqimore dhe mallrave të tjera për përdorim ekskluziv dhe konsumi të forcës në territorin e vendit pritës, do të përjashtohen nga detyrimet doganore dhe taksat, do të depozitohen tek autoritetet doganore të vendit pritës një certifikatë të lëshuar dhe të nënshkruar nga personi i autorizuar i vendit dërgues që përmban specifikimin e mallrave dhe një përshkrim të përdorimit të tyre për nevojat të forcës.

Neni 7

Dispozita financiare

7.1 Shtabet e NATO-s, vendqëndrimet operacionale dhe forcat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e tyre, kur veprojnë për mbështetjen e stërvitjes, do të përjashtohen nga taksat dhe detyrimet në përputhje me nenin 11 të PfP SOFA-s dhe nenin 8 të Protokollit të Parisit.

7.2 Protokollin e Parisit, protokollin tjetër shtesë dhe ligji zakonor ndërkombëtar, i cili vendos imunitete dhe privilegje për shtabet e NATO-s, do të zbatohet për çdo shtab ndërkombëtar, elementet ose detashmentet e shtabeve që mund të dislokohen në vendin pritës për qëllim të stërvitjes.

7.3 Nëse nuk është i mundur përjashtimi i plotë nga taksat, detyrimet, tarifat dhe detyrime të tjera, detyrimet nuk do të jenë në shkallë më të lartë se ato që zbatohen për Forcat e Armatosura të vendit pritës. Gjithë shpenzimet duhet të kryhen me vlerën më të vogël të kërkesave administrative shoqëruese.

7.4 Nëse komandanti i NATO-s përcakton që disa shpenzime janë edhe të ligjshme, dhe të përballueshme për shpenzimet e përbashkëta të NATO-s (nga buxhetet e miratuara), SHAPE do të autorizojë financimin e përbashkët për këto shpenzime dhe do të caktojë komandantin e NATO-s, i cili ose do të paguajë drejtpërdrejt ose do të rimbursojë vendin pritës. Rimbursimi do të bëhet sipas kushteve të mëposhtme: 1. Komandanti i NATO-s ka pranuar paraprakisht kërkesën dhe çmimet e tij.

2. Vendi pritës ose shoqëritë tregtare sigurojnë dokumentacionin e nevojshëm që produkti ose shërbimi në fakt iu është shpërndarë ose i është siguruar forcës.

7.5. Dokumentet pasuese të këtij memorandum mirëkuptimi do të sigurojnë bazën kryesore për shpenzimet e vlerësuara dhe do të shërbejnë si bazë për kategorizimin e shpenzimeve ose si shpenzime të

përbashkëta të NATO-s (nëse është e zbatueshme), kosto të ndara ose shpenzime kombëtare të drejtpërdrejta.

7.6 Nëse disa shpenzime është parashikuar t'i atribuohen më tepër se një vendi, por nuk kualifikohen si shpenzime të përbashkëta të NATO-s, këto shpenzime mund të identifikohen si shpenzime të ndara dhe mund, që me marrëveshje të vendeve të përfshira, të ndahen në përputhje me një formulë për ndarjen e shpenzimeve të parashikuara në marrëveshjen teknike ose dokumente të tjera mbështetëse.

7.7 Vendet dërguese mund të prokurojnë mbështetje dhe shërbime me të njëjtat kushte siç i ofrohen Forcave të Armatosura të vendit pritës.

7.8 Detyrimet për materialet dhe shërbimet për personelin civil dhe ushtarak të siguruar nga vendi pritës nuk do të ngrihen në një shkallë më të lartë se për Forcat e Armatosura të vendit pritës dhe nuk do të përfshijë shpenzime shtesë administrative ose të larta, por mund të reflektojnë rregullime për shkak të përjashtimit nga taksat, programeve të shpërndarjes, pikave të shpërndarjes ose elementeve të ngjashëm. Rimbursimi nuk do të paguhet për mbështetjen e siguruar nga personeli ushtarak.

7.9 Vendi pritës nuk do të shkaktojë ndonjë përgjegjësi financiare në emër të komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese, përveç kur i kërkohet ta bëjë këtë më përpara nga një përfaqësues i autorizuar, dhe nëse nuk është pranuar përgjegjësia për pagimin e shpenzimeve. Për më tepër, asnjë fond nuk do të miratohet deri sa SHAPE ose vendet dërguese të miratojnë dokumentet mbështetëse dhe t'i zbatojnë drejtpërdrejt.

7.10 Financimi nuk jepet në lidhje me këtë memorandum mirëkuptimi dhe ky dokument nuk përfaqëson një detyrim specifik financimi në anën e komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese. Rregullime të veçanta financiare dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet mbështetëse të këtij memorandum mirëkuptimi.

7.11 Vendosja e zonave operacionale për të mbështetur një stërvitje, nuk do të përfshijë ndërtimin ose rehabilitimin e infrastrukturës. Vendi pritës nuk do t'i kërkojë komandantit të NATO-s ose vendeve dërguese të paguajnë shpenzimet e rinovimit për lehtësirat e siguruar nga vendi pritës.

7.12 Mjetet e NATO-s dhe mjetet ushtarake të vendeve dërguese janë të siguruar dhe si të tilla, ato mund të veprojnë pa sigurim tregtar.

7.13 Rregullime financiare të detajuara dhe procedurat e rimbursimit do të specifikohen në dokumentet pasuese të këtij memorandum mirëkuptimi.

Neni 8

Konsiderata ligjore

8.1 Juridiksioni do të përcaktohet në përputhje me dispozitat e përfshira në nenin 7 të NATO SOFA-s.

8.2 Statusi i forcave të dislokuara në territorin e vendit pritës do të përcaktohet në përputhje me PfP SOFA-n, NATO-SOFA-n, Protokollin e Parisit dhe protokollin tjetër shtesë.

8.3 Pajisjet, furnizimet, prodhimet dhe materialet e importuara përkohësisht dhe të eksportuara nga territori i vendit pritës në lidhje me stërvitjen EX CE 05, janë të përjashtuara nga të gjitha detyrimet, taksat dhe tarifatat. Procedura të tjera doganore do të përcaktohen në përputhje me PfP SOFA-n, NATO-SOFA-n, Protokollin e Parisit dhe protokollin tjetër shtesë.

8.4 Ankesat jokontraktuale që rrjedhin nga, ose në lidhje me zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi dhe llojet e mbuluara nga neni 7 i NATO SOFA-s, do të zgjidhen në përputhje me dispozitat e nenit të lartpërmendur.

8.5 Ankesat kontraktuale do të shqyrtohen dhe zgjidhen nga vendi pritës, përmes procesit që drejton kontratat publike dhe në përputhje me ligjet e vendit pritës, me rimbursim nga komandanti i NATO-s ose vendet dërguese.

Neni 9

Mbrojtja e mjedisit

9.1 Vendi pritës do të sigurojë për të gjitha vendet, komandantët e NATO-s dhe komandat, rregullat mjedisore, të cilat do të zbatohen gjatë zhvillimit të stërvitjes. Standardet nuk do të jenë më të rrepta sesa ato të cilat veprojnë në të njëjtën kohë në Forcat e Armatosura të vendit pritës. Këto rregulla do të sigurohen 45 ditë përpara fillimit të stërvitjes. Me njoftimin e vendit pritës për standardet mjedisore, të

gjitha vendet do të veprojnë në përputhje me to gjatë stërvitjes. Dëmet e shkaktuara për shkak të mosrespektimit të standardeve të njoftuara do të kompensohen nga vendi që shkakton dëmin ose ankesat e mundshme do të zgjidhen në përputhje me nenin 8 të NATO SOFA-s.

Neni 10 **Mbrojtja e forcës**

10.1 Mbrojtja e forcës, e plotë dhe efektive, do të planifikohet për qëllim të kësaj stërvitjeje dhe do të detajohet në OPLANS, EXPI ose marrëveshjet shtesë. Mbrojtja e forcës do të zbatohet në përputhje me politikën dhe procedurat e NATO-s dhe në mënyrë të pajtueshme me NATO-PfP-SOFA-n. Mbrojtja e forcës, në asnjë mënyrë nuk do të kërkohej ose të sigurohet në kundërshtim me NATO/PfP/SOFA ose ligjet e vendit pritës.

10.2 Për sa nevojitet, vendi pritës do të informojë vendin dërgues dhe komandantin e NATO-s për masat dhe kufizimet e propozuara të mbrojtjes së forcës.

10.3 Për sa nevojitet, secili vend dërgues është përgjegjës për identifikimin dhe sigurimin e kërkesave dhe kufizimeve të mbrojtjes së forcës, vendit pritës dhe komandantit të NATO-s.

10.4 Përveç përgjegjësiave të mbrojtjes së forcës, të përcaktuara në politikën dhe procedurat e NATO-s, komandanti i NATO-s është përgjegjës për koordinimin e mbrojtjes së forcës të kërkuar dhe të siguruar nga vendi pritës dhe vendet dërguese aq sa nevojitet për mbrojtjen e forcës së tij.

Neni 11 **Siguria dhe zbulimi i informacionit**

11.1 Të gjitha informacionet e klasifikuara të shkëmbyera ose që lidhen me planifikimin dhe zbatimin e stërvitjes do të përdoren, transmetohen, magazinohen, ruhen dhe do të mbrohen në përputhje me procedurat e sigurisë së NATO-s, si dhe me rregullat e ligjet e sigurisë kombëtare të vendit pritës dhe të vendeve dërguese, në masën që ato sigurojnë një shkallë jo më të rreptë se ajo që sigurohet për informacionet e klasifikuara të NATO-s të detajuara në Siguria brenda Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut C-M (2002)49.

11.2 Informacioni i siguruar nga një pjesëmarrës ose vendi dërgues një tjetri në konfidencë dhe një informacion i prodhuar nga një pjesëmarrës ose vend dërgues për shkak të këtij memorandumi mirëkuptimi ose do të mbajë klasifikimin e tij origjinal, ose do t'i caktohet një nivel klasifikimi që do të sigurojë një shkallë mbrojtjeje kundër zbulimit të tij, i njëjtë me atë që kërkohej nga pjesëmarrësi tjetër ose vendi dërgues.

11.3 Secili pjesëmarrës do të ndërmarrë hapat ligjorë të nevojshëm për të mbrojtur nga zbulimi të gjithë informacionin e shkëmbyer në konfidencë sipas këtij memorandumi mirëkuptimi, përveç kur pjesëmarrësi e miratojnë këtë zbulim.

11.4 Për të ndihmuar në sigurimin e mbrojtjes së kërkuar, secili pjesëmarrës ose vend dërgues do të shënojë informacionin e dhënë tjetrës në konfidencë, me një legjendë që tregon origjinën e tij, nivelin e klasifikimit, kushtet e përhapjes, që ky informacion ka lidhje me këtë memorandum mirëkuptimi dhe që është dhënë në konfidencë.

11.5 Informacionet dhe materialet sipas nenit 11 do të vazhdojnë të mbrohen në rast të tërheqjes nga ndonjë pjesëmarrës ose me përfundimin e memorandumi të mirëkuptimit.

11.6 Vizitat e personelit do të kryhen në përputhje me procedurat e specifikuar në C-M (2002) 49, i ndryshuar.

Neni 12 **Pjesëmarrja e vendeve dërguese**

Vendet dërguese që duan të marrin pjesë në stërvitjen, sipas kushteve të këtij memorandumi mirëkuptimi, do të tregojnë qëllimin e tyre me nënshkrimin nga përfaqësuesi i autorizuar i vendit dërgues, të një note pranimi dhe/ose të një deklarimi qëllimi për të marrë pjesë, në formën e përcaktuar në aneksin A të këtij memorandumi mirëkuptimi ose në formë tjetër, siç mund të pranohet bashkërisht nga vendi pritës dhe vendet dërguese.

Neni 13 **Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja**

13.1 Ky memorandum mirëkuptimi do të hyjë në fuqi në datën e njoftimit të fundit me anën e të cilit Palët njoftojnë njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e tij në fuqi. Ky memorandum mirëkuptimi do të mbetet në fuqi deri në 30 ditë pas përfundimit të stërvitjes CE 05, duke mbajtur parasysh që, për çështjet financiare të pazgjidhura dhe për ndonjë ankesë të mundshme, ky memorandum mirëkuptimi do të mbetet në fuqi deri sa këto çështje të jenë përfunduar dhe zgjidhur. Periudha e kohës, gjatë të cilit ky memorandum mirëkuptimi do të mbetet në fuqi, mund të zgjatet me pëlqim të përbashkët të pjesëmarrësve.

13.2 Dispozitat e nenit 7, 10 dhe 11 do të mbeten në fuqi në rast të tërheqjes të ndonjë pjesëmarrësi ose pas përfundimit të këtij memorandum mirëkuptimi, me përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Vendet dërguese do të përmbushin të gjitha detyrimet në rast të ndonjë përfundimi ose tërheqjeje.

Neni 14

Ndysimet dhe interpretimi

14.1 Ky memorandum mirëkuptimi mund të shtohet ose ndryshohet me shkrim, me pëlqim të përbashkët të të gjithë pjesëmarrësve.

14.2 Ky memorandum mirëkuptimi nuk bie ndesh me ligjet e vendit pritës dhe detyrimet që rrjedhin nga traktatet. Mosmarrëveshjet do të zgjidhen me negociata midis pjesëmarrësve.

14.3 Çdo konflikt për interpretimin dhe zbatimin e këtij memorandum mirëkuptimi do të zgjidhet në konsultim mes palëve në nivelin më të ulët të mundshëm dhe nuk do t'i referohet për zgjidhje një gjykate kombëtare ose ndërkombëtare ose një pale të tretë për zgjidhje.

Bërë në _____, më _____ 2005, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe atë angleze, të dy tekstet me vlerë autentike.

Në rast të ndryshimeve në përkthim, do të merret për bazë teksti në gjuhën angleze.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Sadedin Stankaj

PËR KOMANDËN SUPREME TË FORCAVE TË ALEANCËS NË EUROPE (SHAPE)

Rainer Schuwirth

General, GE A

Chief of Staff

Supreme Headquarters Allied Powers Europe

ANEKSI A I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Dokumente të zbatueshme

Dokumentet e mëposhtme do të zbatohen për qëllimet e stërvitjes në masën që ato nuk bien në kundërshtim me ligjet e vendit pritës.

a) Marrëveshja mes shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në PfP, për sa i përket statusit të forcave të tyre (PfP SOFA), bërë në Bruksel, më 19 qershor 1995;

b) Protokollin shtesë i marrëveshjes mes shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në PfP, për sa i përket statusit të forcave të tyre;

c) MC 36/2 - Ndarja e përgjegjësisë në kohë lufte midis komandantëve kombëtarë dhe komandantëve madhorë të aleancës;

d) MC 317- Struktura e forcës së NATO-s;

e) MC 319/1- Politikat dhe parimet logjistike të NATO-s;

f) MC 326/1- Politikat dhe parimet e mbështetjes mjekësore;

g) MC 334/1 - Politikat e NATO-s për MVP-në;

h) MC 336/1- Koncepti i lëvizjes dhe transportimit për NATO-n;

i) MC 400/2 - Guida e NATO-s për zbatimin ushtarak të strategjisë së aleancës;

j) STANAG-et e NATO-s dhe direktivat e zbatueshme për mbështetjen logjistike, mbrojtjen e forcës dhe rimbursimin financiar;

k) Koncepti i NATO-s për operacionet detare (CONMAROPS);

l) ALP – 9 - Doktrina e logjistikës së forcës;

m) ALP – 11- Logjistikë ndërkombëtare e Forcave Detare;

n) AJP - 4.5 (A) Publikimi i përbashkët i aleancës për doktrinat dhe procedurat e MVP-së së NATO-s;

o) ALP — 13 Doktrina e logjistikës ajrore (DRAFT);

p) AAP — 6 Përmbledhje e kushteve;

q) Guidat e planifikimit operacional (GOP);

r) C — M (2002) 49 Siguria në Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut.

ANEKSI B I MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT

Notë pranimi/deklarim qëllimi për të marrë pjesë në MVP dhe përgjegjësi financiare dhe të tjera që lindin në Republikën e Shqipërisë (vendi pritës) për stërvitjen “Cooperative engagement” 05

Qeveria e _____ (vendi pritës), përfaqësuar nga _____,

duke vendosur që Forcat e tij të Armatosura do të vendosin të marrin pjesë në stërvitjen Cooperative Engagement 05;

duke konsideruar konceptin e stërvitjeve të NATO/PfP brenda doktrinës së NATO-s;

duke dëshiruar të marrin pjesë në rregullimet lidhur me MVP dhe përgjegjësitë financiare ose të tjera të Republikës së Shqipërisë (vendi pritës), Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE) dhe vendeve të tjera dërguese, lidhur me mbështetjen e Forcave të tyre të Armatosura gjatë stërvitjes;

zgjedhin të marrin pjesë në dhe të mbështeten nga dispozitat e parashikuara në:

Memorandumin e mirëkuptimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komandës Supreme të Forcave të Aleancës në Europë (SHAPE), lidhur me dispozitat e mbështetjes së vendit pritës, gjatë stërvitjes Cooperative Engagement 05 (MM për MVP), e cila ka hyrë në fuqi në _____, si më poshtë;

Si vend dërgues, (përshkruar në memorandum mirëkuptimi si “vendi dërgues”, për planifikimin, përgatitjen (zhvillimin) e stërvitjes sipas MM të lartpërmendur. (Në rast se ka rezerva, këto do të shtohen në fjali “subjekt i rezervave të mëposhtme” dhe pas kësaj do të jepet lista e rezervave, nëse nevojitet).

Për Qeverinë e _____ (vendi dërgues)

LIGJ

Nr.9422, datë 29.9.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, BANKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR ASISTENCË FINANCIARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Bankës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për asistencë financiare”, në shumën 9 000 000 (nëntë milionë) euro.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4671, datë 20.10.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë

MARRËVESHJE HUAJE
NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN SI HUADHËNËS, SHQIPËRISË SI HUAMARRËS
DHEBANKËS SË SHQIPËRISË SI AGJENT I HUAMARRËSIT

Kjo Marrëveshje Huaje (Marrëveshja) është bërë 9 000 000 euro midis Komunitetit Europian, në vijim i referuar si “KE” ose “Huadhënësi”, i përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve Europiane, në vijim i referuar si “Komisioni”, në emër të të cilit vepron z.Joaquin Amunia, anëtar i Komisionit, dhe Republikës së Shqipërisë, në vijim i referuar si “Shqipëria” ose “Huamarrësi”, i përfaqësuar nga z.Arben Malaj, Ministër i Financave të Shqipërisë dhe Bankës së Shqipërisë, e cila vepron si Agjente në emër të Huamarrësit, në vijim i referuar si “Agjent”, përfaqësuar nga z.Ardian Fullani, Guvernator i Bankës së Shqipërisë.

Hyrje

Duke pasur parasysh se autoritetet kanë kërkuar asistencë të mëtejshme nga KE-ja,

Duke pasur parasysh se Këshilli i Komunitetit Europian, në vijim i referuar si “Këshilli”, me anë të vendimit të tij 2004/580/KE të datës 29 prill 2004 (Vendimi), ka vendosur të sigurojë asistencë makro-financiare për Shqipërinë, duke dhënë një hua në shumën maksimale prej 9 milionë euro për të ndihmuar vendin që të përmbushë nevojat financiare të huaja, përfshirë fuqizimin e rezervave dhe mbështetjen buxhetore,

Duke pasur parasysh se Këshilli ka autorizuar Komisionin të bjerë dakord me autoritetet e Huamarrësit, pas konsultimit me Komitetin Ekonomik dhe të Financave, kushtet e politikave ekonomike që i bashkëngjiten asistencës financiare,

Duke pasur parasysh se Komisioni është konsultuar me Komitetin Ekonomik dhe të Financave për këto kushte,

Duke pasur parasysh se autoritetet e Huamarrësit kanë ndërmarrë angazhimin për të përmbushur kushtet e parashikuara nga asistencja makro-financiare, ashtu siç është rënë dakord me Komisionin në një memorandum mirëkuptimi (në vijim i referuar si Memorandumi), që i bashkëngjitet dhe që është një pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje,

Duke pasur parasysh se Komisioni është autorizuar për të marrë hua burimet e nevojshme në emër të KE-së,

Duke pasur parasysh se në përputhje me dispozitat e vendimit, kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe të memorandumit, huaja në shumën 9 milionë euro do të mundësohet për Shqipërinë në një transh të vetëm në përputhje me dispozitat e memorandumit dhe të kushteve të kësaj Marrëveshjeje,

Duke pasur parasysh se në zbatim të kësaj huaje, Komisioni, në emër të KE-së, pas Marrëveshjes me Huamarrësin për kushtet kryesore financiare (që do të thotë norma e interesit, shumat e përafërta neto, maturimi), do të emetojë një obligacion për shumën totale të principalit prej 9 milionë euro, ose për ndonjë transaksion tjetër të përafërt financiar, shumat e të cilave do t’i huazohen Shqipërisë dhe do të disbursohen në një llogari, që Shqipëria do ta hapë me Agjentin ditën kur të jenë marrë nga Komisioni (data e pagesës) dhe Huadhënësi do të bëjë përpjekjet më të mira për ta marrë atë sipas gjykimit të vet sipas kushteve më të mira të disponueshme të tregut për transaksionet në fjalë. Ndërsa një kopje e çdo kontrate lidhur me emetimin e obligacionit të lartpërmendur ose të çdo transaksioni tjetër financiar të duhur, në vijim i referuar si “Kontratat e huamarrjes” do t’i bashkëngjiten si anekse, duke pasuar ekzekutimin e secilës në lidhje me Marrëveshjen dhe do të formojnë një pjesë përbërëse të saj, ashtu siç është parashikuar këtej e tutje.

Për sa më sipër, palët kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1
Vlera e huasë

Huadhënësi do të bëjë të mundur për Huamarrësin huanë prej 9 milionë euro, shumën kryesore (huaja) në një transh, subjekt i afateve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin, në këtë Marrëveshje dhe

në memorandum bashkëngjitur.

Neni 2

Të ardhurat neto, tërheqjet dhe kushtet paraprake

1. Shumat neto (në vijim referuar si shumat neto) të huasë do të jenë të barabarta me shumat neto të një ose më shumë transaksioneve financiare që KE është përfshirë për të financuar huanë (transaksionet financiare) minus shumën totale të kostove dhe të shpenzimeve lidhur me transaksionet financiare dhe përgatitjen, dhe ekzekutimin e transaksioneve të tilla nga huaja.

2. Shumat neto të huasë, siç parashikohet në paragrafin e mëparshëm, do të transferohen në datën e pagesës në llogarinë bankare euro të Agjentit, me numër 100 92 12 15 000 pranë Deutsche bank, Frankfurt am Main, SWIFT code: Deutdeff, ose në ndonjë llogari tjetër euro të sugjeruar me shkrim ndaj Huadhënësit nga Agjenti të paktën 6 ditë-punë para datës së pagesës. Nëse fondet transferohen te buxheti, Ministria e Financave dhe e Thesarit të Shqipërisë dhe Agjenti do t'i japin Komisionit një njoftim zyrtar mbi transferimin e ekuivalentit të shumës në monedhë lokale të mbajtur në llogarinë e Agjentit.

3. Detyrimi i KE-së, për të transferuar shumat neto për të Huamarrësi lidhur me Huanë, do t'i nënshtrohet:

1. Marrjes nga Komisioni të të paktën dy ditëve punë Luksemburgu përpara datës në të cilën KE-ja ka ndërmend të kryejë transaksione financiare për huanë, një datë e tillë do t'i komunikohet përpara Huamarrësit, të opinioneve ligjore të arsyeshme dhe të pëlqyeshme të dhëna për Komisionin nga: a) Z.Fatmir Xhafa, Ministër i Drejtësisë i Shqipërisë ose një nga zëvendësit e tij dhe b) Z.Dominico Apicella nga Studio Ligure Tonucci ose nga ndonjë këshilltar ligjor i pavarur për Huadhënësin. Këto mendime ligjore duhet t'i përkasin një date jo më të hershme sesa data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, ashtu siç përcaktohet në nenin 12, dhe jo më vonë se dy ditë-punë Luksemburgu përpara datës në të cilën KE-ja ka ndërmend të kryejë transaksionin financiar dhe duhet të shpallë në respektim të ligjeve, rregulloreve dhe vendimeve të detyrueshme ligjërish, aktualisht të zbatueshme në vendin e Huamarrësit. Huamarrësi gjatë ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje përfaqësohet nga Z.Arben Malaj, Ministër i Financave, i zotuar rregullisht dhe e parevokueshme për të përmbushur detyrimet që parashikohen nga kjo Marrëveshje.

Huamarrësi dhe Agjenti zotohen të informojnë Huadhënësin, menjëherë, nëse ndërmjet datës së mendimit ligjor sipas a) më sipër dhe datës së transaksionit financiar, një datë e tillë t'i komunikohet Agjentit nga Huamarrësi dhe datës së transaksionit financiar ndodh ndonjë ngjarje që mund të bëjë jo të saktë çdo deklaratë të bërë në opinionet ligjore.

2. KE nga njëra anë dhe një bankë ose sindikatë e bankave në anën tjetër, pasi kanë nënshkruar kontratat e huamarrjes të paktën dy ditë-punë përpara datës së pagesës dhe pasi KE-ja të ketë marrë në ditën e pagesës shumat neto të transaksionit financiar nga banka në fjalë ose sindikata e bankave.

3. Nëse nuk ka ndodhur anjë ndryshim i pafavorshëm material që nga data e ekzekutimit të Marrëveshjes që, sipas mendimit të Huadhënësit, pas konsultimeve me Huamarrësin, ka shumë të ngjarë të ekzistojë mundësia për të paragjykuar materialisht aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij të pagesave sipas kësaj Marrëveshjeje p.sh., për të bërë të mundur shërbimin e huasë dhe shlyerjen e saj.

Neni 3

Gjendja dhe zotimet

1. Huaja sipas kësaj Marrëveshjeje do të përbëjë një detyrim të pasiguar, direkt dhe të pakushtëzuar dhe të përgjithshëm për Huamarrësin dhe do të ketë epërsi *pari passu* ndaj të gjitha huave dhe detyrimeve të pasiguruara të tanishme dhe të ardhshme të Huamarrësit që rrjedhin nga borxhi i jashtëm i tanishëm dhe i së ardhmes, ashtu siç parashikohet në nenin 8 paragrafi 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Huamarrësi merr përsipër, deri në kohën kur i gjithë principali sipas kësaj huaje është rimbursuar plotësisht dhe të gjitha interesat, si dhe shumat shtesë nëse ka të tilla sipas huasë janë paguar plotësisht dhe me përjashtim të barreve të renditura në paragrafin 3 të nenit 3, të mos sigurojë hipotekë, peng ose çdo barrë në pasuritë e tij ose të ardhurat, të çdo borxhi të jashtëm aktual ose të ardhshëm dhe çdo garancie ose dëmshpërblimi të dhënë në lidhje me këtë, përveçse kur huaja ka epërsi *pari passu* dhe *pro rata* në sigurinë e dhënë. Huamarrësi merr përsipër gjithashtu të mos kërkojë riskedimin e huasë ose të ndonjë lehtësimi borxhi në lidhje me huanë ose çdo hua të mëparshme të dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi, me përjashtim të borxheve të parashikuara sipas paragrafit 3 të këtij neni, si dhe nuk do t'i jepet asnjë kreditori tjetër përparësi sipër Huadhënësit.

3. Huamarrësi, në respektim të zotimit të tij sipas paragrafit 2, mund të lejojë vetëm barrat në vijim:

1) Barrat mbi çdo pronë të vënë për të siguruar marrjen e çmimit të kësaj prone dhe çdo ripërtëritje

dhe zgjatje e kësaj barre, e cila kufizohet me pronën origjinale të mbuluar nga ajo dhe e cila siguron çdo ripërtëritje ose zgjatje të financimit të siguruar;

2) Barrat mbi të mirat tregtare të rrjedhin nga zhvillimi i transaksioneve bankare tregtare të zakonshme (dhe që skadojnë tek e fundit brenda një viti në vijim) për financimin e importimit ose eksportimit të këtyre të mirave në ose nga vendi i Huamarrësit; dhe

3) Barrat që sigurojnë ose mundësojnë pagesën e borxhit të jashtëm, i marrë vetëm për të mundësuar financim për projekte të arsyeshme dhe të mirëpërcaktuara të investimit, parashikojnë që pronat ndaj të cilave këto barra zbatohen janë prona të cilat i nënshtrohen financimit të këtyre projekteve ose të cilat janë të ardhura ose pretendime që rrjedhin nga projekti;

4) Çdo barrë tjetër që ekziston prej kësaj date, të parashikuara që këto barrat do të ngelen të lidhura me pronat mbi të cilat ato rëndojnë dhe pronat mbi të cilat rëndojnë këto barra sipas kontratave në fuqi në ditën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje dhe të parashikuara më tej që këto barra sigurojnë ose mundësojnë pagimin e vetëm të këtyre detyrimeve të siguruar ose të parashikuara për në datën në vijim ose çdo rifinancim të këtyre detyrimeve;

5) Të gjitha barrat e tjera ligjore dhe privilegjet, të cilat veprojnë vetvetiu nga ligji, të cilat nuk mund të evitohen në mënyrë të arsyeshme nga Huamarrësi. Ashtu siç është përdorur në këtë paragraf, financim i një projekti nënkupton çdo financim ose përvetësim, ndërtim ose zhvillim të çdo prone në lidhje me një projekt nëse entiteti që mundëson një financim të tillë shprehet dakord për të parë pronat e financuara dhe të ardhurat e nxjerra nga veprimi i, ose humbja, ose dëmtimi i këtyre pronave si burimi kryesor i shlyerjes për paratë e kaluara.

Neni 4

Interesi

1. Norma e interesit mbi huanë dhe datat e duhura për pagesat e interesit do të jenë të njëjta me ato të përcaktuara në nenet përkatëse të kontratave të huamarrjes. Në rastin e një norme të interesit të ndryshueshëm, kjo normë nuk do të jetë më e madhe se 6 muaj euribor plus 0.20% në vit, dhe Huadhënësi do të këshillojë Agjentin të paktën një muaj përpara datës përkatëse të shumës së interesit përkatës dhe të pagueshëm në datën në fjalë dhe të detajeve (norma e interesit, periudhë interesi) mbi të cilat bazohet llogaritja e interesit. Në rastin e një norme interesi fiks, kjo normë nuk do të jetë më e lartë se 6.00% në vit. Nëse Huadhënësi, për shkak të kushteve mbizotëruese të tregut në kohën e emetimit të një obligacioni ose të çdo transaksioni tjetër financiar nuk është në gjendje për të marrë fondet poshtë ose sipër maksimumit të normave të interesit, atëherë Huadhënësi nuk ka asnjë detyrim për të bërë të mundur ndaj Huamarrësit shumat neto të huasë dhe në bazë të kërkesës nga Huamarrësi, Huadhënësi do t'i propozojë Huamarrësit të negociojnë normat e reja maksimale të interesit në kuadër të kushteve mbizotëruese të tregut.

2. Sipas kërkesës së Huamarrësit dhe nëse sipas gjykimit të Huadhënësit rrethanat lejojnë një përmirësim të normës së interesit të huasë, Huadhënësi mundet që, në përputhje me nenin 5 paragrafi 3 të vendimit, të riformulojë kushtet financiare të huamarrjeve të Huadhënësit, kur parashikohet që kontratat përkatëse të huamarrjes lejojnë një riformulim të tillë ose që Huadhënësi mund të diskutojë kontratat e huamarrjes.

3. Nëse shumat neto të huasë nuk mund të transferohen në datën e pagesës për çdo arsye tjetër veç atyre të përmendura në nenin 2 paragrafi 3(3), atëherë Huadhënësi do t'i depozitojë këto shuma në vlerën më të mirë të disponueshme të tregut për depozitë me afat dhe, pa vonesë, të lajmërojë Agjentin mbi këtë fakt dhe mbi normën e interesit të përfituar. Interesi i marrë nga Huadhënësi mbi këtë depozitë do të zbritet nga pagesat e interesit të duhura dhe të pagueshme nga Huamarrësi.

4. Nëse Huamarrësi dështon në pagimin e principalit ose të interesit të pagueshëm sipas kësaj Marrëveshjeje në datën e caktuar, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit interes shtesë mbi këto shuma (ose, nëse është rasti, shumën në vijim nga koha kur kjo është bërë e pagueshme dhe nuk është paguar) nga data përkatëse deri më datën aktuale të pagesës, e llogaritur në mënyrë të plotë, duke iu referuar periudhave të interesit pasues (çdo kohëzgjatje e tillë, për sa kohë Huadhënësi mundet që nga koha në kohë të përzgjedhë, periudhën e parë ta fillojë në datën e lidhur dhe kur është e mundur, kohëzgjatja e kësaj periudhe do të jetë një javë) më të lartë se:

a) norma për një vit si shumë totale e:

i) një për qind (1 për qind) në vit dhe

ii) vlera euribor për kohëzgjatjen përkatëse ose

b) një për qind (1%) në vit plus normën e interesit të huasë, ashtu siç përcaktohet nga neni 4 paragrafi 1.

Përsa kohë vazhdon dështimi për të paguar, një normë e tillë do të rivendoset në përputhje me

dispozitat e këtij paragrafi 4 në ditën e fundit të çdo periudhe të këtij interesi dhe interesit të papaguar sipas paragrafit 4 në lidhje me periudhat e mëparshme të interesit do t'i shtohet shumës së interesit përcaktues në fund të çdo periudhe interesi.

Nëse Huamarrësi dështon në pagimin e çdo kostoje ose shpenzimi tjetër për t'iu paguar Huadhënësit në datën kur këto bëhen të pagueshme rregullisht, në përputhje me këtë Marrëveshje, atëherë Humarrësi do të paguajë si shtesë të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë taksat ligjore që lindin nga Huadhënësi për shkak të këtij pagimi të vonuar, ashtu siç përcaktohet nga Huadhënësi.

Gjithashtu Huamarrësi merr përsipër t'i paguajë Huadhënësit të gjithë interesin shtesë dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet, duke përfshirë tarifat ligjore që lindin dhe të pagueshme nga Huadhënësi, si rezultat i mospërbushjes nga Huamarrësi të detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

Huadhënësi merr përsipër të informojë Agjentin mbi detajet e llogaritjes së interesit dhe në veçanti të referencës së përdorur për vendosjen e euribor-it nëse është e zbatueshme.

Neni 5

Shlyerja dhe zgjedhja për parapagesën

1. Humarrësi do të shlyejë shumën principale të huasë, në këste vjetore, në datat dhe sipas kushteve të përcaktuara në kontratat e huamarrjes, të cilat do të kryhen në mënyrë të tillë që kësti i parë do të jetë i shlyeshëm në vitin e 11-të (njëmbëdhjetë) të datës përkatëse të pagesës dhe shlyerja përfundimtare do të bëhet në vitin e 15-të (pesëmbëdhjetë) të datës përkatëse të pagesës.

2. Me qëllim që të përfitohen fonde më të lira, Huamarrësi nuk i kërkon Huadhënësit të përfshijë klauzolë për shlyerje të parakohshme në afatet dhe kushtet e huasë. Sidoqoftë, Huamarrësi ka të drejtë të kërkojë, në përputhje me nenin 5 paragrafi 2 të vendimit, një mundësi shlyerjeje të parakohshme, që kërkon marrjen e një njoftimi me shkrim nga Huadhënësi mbi këtë fakt të paktën 6 ditë-punë përpara datës në të cilin KE-ja ka ndërmend të kryejë një transaksion financiar për huanë. Afatet dhe kushtet e kësaj mundësie shlyerjeje të parakohshme për Huamarrësin do të jenë ato korresponduese të mundësisë për një shlyerje të parakohshme për Huadhënësin sipas kontratave të huamarrjes, që parashikojnë që Huamarrësi të njoftojë Huadhënësin për vendimin e tij për të shlyer para kohe huanë, të paktën një muaj përpara datës së fundit të njoftimit për shlyerje të parakohshme sipas kontratave të huamarrjes.

Neni 6

Pagesat

1. Të gjitha pagesat që do të bëhen nga Humarrësi, nuk do t'i nënshtrohen pagesës së asnjë takse, komisioni dhe çdo zbritjeje tjetër për të gjithë kohën e kësaj Marrëveshjeje.

2. Humarrësi deklaron që të gjitha pagesat dhe transfertat e bëra në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, përfshirë vetë Marrëveshjen, nuk i nënshtrohen asnjë takse ose tatimi në vend dhe nuk do t'i nënshtrohen për të gjithë kohën e kësaj Marrëveshjeje. Sidoqoftë nëse Huamarrësi është i detyruar nga ligji për të bërë zbritje të tilla, Huamarrësi do të paguajë shumat shtesë të kërkuara me qëllim që Huadhënësi të marrë shumën e plotë të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

3. Të gjitha pagesat nga Huamarrësi duhet të bëhen në euro në llogarinë në euro të Huadhënësit me Kredietbank S.A.Luksemburg, swift code KBLXLULL, nr.i llogarisë 45 7050 5231 9440 6500 ose në llogari tjetër, sikurse Huadhënësi do të udhëzojë Huamarrësin dhe Agjentin me një njoftim të shkruar të paktën 6 ditë-punë përpara datës përkatëse.

4. Huamarrësi merr përsipër të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet e arsyeshme të ndodhura dhe të pagueshme nga Huadhënësi për përgatitjen dhe zbatimin e huasë dhe të transaksioneve financiare përkatëse, kontratave të huasë, dhe çdo kosto apo shpenzim që lidhet me transaksionet financiare ose *swaps* nëse ka të tilla, dhe kosto dhe shpenzime përkatëse gjatë kohëzgjatjes së transaksionit financiar, përveç atyre kostove dhe shpenzimeve të shkaktuara nga mospagimi ose të një neglizhence të madhe nga KE-ja. Kostot që lindin nga Huamarrësi, përfshijnë kostot ligjore (p.sh. kostot që shkaktohen për opinionet ligjore), kostot e udhëtimit, komisionet e lidhura me shërbimin financiar të transaksionit financiar, tatimet dhe taksat e regjistrimit, si edhe ato të publikimit nëse do të ketë. Shumat e përmendura më sipër, nëse nuk zbriten nga shumat neto në përputhje me nenin 2 paragrafi 1, do të paguhet nga Huamarrësi brenda një

muaji pas njoftimit nga Huadhënësi, njoftim i tillë do të shoqërohet nga dokumente mbështetëse.

5. Nëse Huamarrësi do të paguajë një shumë në lidhje me huanë, e cila është më pak se shumë e përgjithshme përkatëse dhe e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi në këtë mënyrë heq dorë nga çdo e drejtë që mund të ketë për të bërë çdo përvetësim të shumës së paguar kundrejt shumave të duhura.

Një shumë e tillë, e paguar nga huaja, do të zbatohet në ose drejt përmbushjes së pagesave të duhura nga kjo hua në radhë të parë në vijim të çdo takse dhe shpenzimi dhe në radhë të dytë të çdo interesi për pagesa të vonuara, siç përcaktohet nga neni 4 paragrafi 4 i Marrëveshjes, së treti kundrejt interesit, së katërti kundrejt principalit, me parashikim se këto shumë janë të duhura ose të vonuara për t'u paguar në atë datë.

Neni 7

Angazhimet lidhur me kontrollet, parandalimin e vjedhjeve dhe auditimet

1. Komisioni, përfaqësuar nga agjentët e tij, ose ekspertët e tij të mandatar, kanë të drejtën të kryejnë vlerësimet operacionale të procedurave administrative dhe financiare të Huamarrësit dhe të Agjentit, që lidhen me menaxhimin e asistencës makro-financiare të KE-së.

2. Komisioni, përfshirë Zyrën Europiane kundër Vjedhjeve dhe Gjykatën Europiane të Auditorëve, kanë të drejtën të dërgojnë agjentët e tyre ose përfaqësuesit e autorizuar për të kryer kontrolle teknike ose financiare, ose auditime që ata i konsiderojnë të nevojshme lidhur me menaxhimin e kësaj asistence gjatë gjithë periudhës së huasë.

3. Huamarrësi dhe Agjenti do të sigurojnë të gjithë informacionin dhe dokumentet që mund të kërkojnë për qëllimin e vlerësimeve, kontrolleve ose auditimeve, dhe të marrin masat e nevojshme për të lehtësuar punën e personave të udhëzuar prej tyre. Huamarrësi dhe Agjenti marrin përsipër t'u japin personave të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 akses në vendet ku ruhet dokumentacioni dhe informacioni.

4. Huamarrësi dhe Agjenti do të kryejnë ekzaminimin dhe trajtimin e duhur të çdo rasti të dyshuar dhe aktual të vjedhjes, korrupsionit ose çdo aktiviteti tjetër ilegal lidhur me menaxhimin e asistencës makro-financiare të KE-së, që është në kundërshtim të interesave financiare të KE-së. Të gjitha këto raste, si dhe masat përkatëse që merren nga autoritetet vendase kompetente do t'i raportohen pa vonesë Komisionit.

Neni 8

Ngjarjet e mospagesës dhe shlyerjet e parakohshme

1. Huadhënësi, duke i dërguar një njoftim me shkrim Huamarrësit, mund të deklarojë shumën principale të papaguar të Huasë si menjëherë të kërkueshme dhe të pagueshme, së bashku me interesat e përfshira dhe të gjitha shumat e tjera të duhura nëse:

a) Huamarrësi do të dështojë për të paguar, në kohën e duhur të përcaktuar, ndonjë pagesë të principalit ose interes qoftë në total, ose në pjesën në mënyrën dhe monedhën e rënë dakord në këtë Marrëveshje, në lidhje me huanë dhe vonesën në pagesë nuk do të shtyhet nga pagesat në vijim brenda 5 ditëve-punë pas njoftimit të shkruar që i është dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

b) Huamarrësi do të vonohet në plotësimin e ndonjë detyrimi tjetër sipas Marrëveshjes, të tjera nga ato të përfshira në memorandum dhe një vonesë e tillë do të vazhdojë për 30 ditë pas njoftimit me shkrim që i është dhënë Huamarrësit nga Huadhënësi në përputhje me nenin 9; ose

c) për çdo arsye çfarëdoqoftë ajo, si pasojë e një veprimi ose mosveprimi nga një institucion ose individ, ose organ që ka pushtet ligjor brenda territorit të Huamarrësit, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes kundërshtohen si të detyrueshme mbi ose të zbatueshme kundër Huamarrësit; ose

d) është përcaktuar se lidhur me Huanë, Huamarrësi ose Agjenti janë përfshirë në ndonjë veprim vjedhjeje ose korrupsioni ose aktivitet tjetër ilegal në kundërshtim me interesat financiare të KE; ose

e) ka një marrëveshje huaje të mëparshme midis vendit të Huamarrësit, Agjentit dhe një institucioni të KE-së (ky term nënkupton Komunitetin European, Komunitetin European të Energjisë Atomike, Komunitetin European të Gazit (në likuidim), Bankën e Investimeve Europiane dhe çdo agjenci, autoritet, komitet, departament, institucion legjislativ ose zyrë) ose sipas një borxhi huaje të jashtme të vendit të Huamarrësit një deklaratë vonese siç përcaktohet, instrument qeveritar ose që tregon një borxh të

tillë dhe si rezultat i kësaj deklarate vonese, ka një përshpejtim të një borxhi të tillë; ose

f) Huamarrësi nuk paguan përgjithësisht borxhet e tij të jashtme brenda kohës ose do të deklarojnë ose imponojnë një moratorium mbi pagesën e borxhit të jashtëm të Huamarrësit ose të një borxhi të jashtëm të supozuar ose të garantuar nga ai.

Për qëllim kuptimin në vijim, “borxh i jashtëm” i Huamarrësit “nënkupton çdo borxh të kontraktuar, garantuar ose ndryshe të siguruar nga Huamarrësi ose Agjenti”, e cila është, qoftë e:

i) përcaktuar në një monedhë tjetër nga monedha e Huamarrësit; ose

ii) e rrjedhur ose e ndodhur (në çdo lloj monedhe) jashtë vendit të Huamarrësit.

2. Huadhënësi mundet, por nuk është i detyruar t’i ushtrojë të drejtat e tij sipas këtij neni, dhe mundet gjithashtu t’i ushtrojë vetëm ato pjesërisht, pa asnjë paragjykim në lidhje me ushtrimin e këtyre të drejtave në të ardhmen.

3. Huamarrësi do të rimbursojë Huadhënësin për të gjitha kostot dhe shpenzimet e kryera, komisione dhe humbje të interesit që lindin dhe janë të pagueshme nga KE-ja si pasojë e një shlyerjeje të parakohshme të huasë sipas nenit 8. Humbja e interesit është diferenca ndërmjet normës së interesit të huasë dhe interesit të përvetësuar nga KE-ja nga riinvestimi i shumave të shlyera përpara kohe për periudhën ndërmjet datës së shlyerjes së parakohshme dhe datës në të cilën transaksioni financiar maturohet ose mund të përfundohet sipas kushteve të kontratave të huasë.

Neni 9 Njoftimet

Të gjitha njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhen me shkrim dhe duhet të dërgohen në:

Për KE-në
Komisioni i Komuniteteve Europiane
Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Çështjeve Financiare
Drejtoria e Operacioneve Financiare, menaxhimi i programeve dhe bashkëpunimi me Grupin e Huamarrjes BEI, programet e Huadhënies dhe Joint Venture
Qendra A.Wagner
L-2920 Luksemburg

Tel: (352) 430133150
Fax: (352) 430136599

Për Huamarrësin
Ministria e Financave dhe e Thesarit të Shqipërisë
Ministri i Financave
Arben Malaj
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Tiranë, Shqipëri

Tel: 355 4 228405
Fax: 355 4 228494

Për Agjentin
Banka e Shqipërisë
Guvernatori
Ardian Fullani
Sheshi Skënderbej, nr.1
Tiranë, Shqipëri

Tel: 355 4 228421
Fax: 355 4 223558

Njoftimet për Huamarrësin ose për Agjentin mund të jenë të vlefshme nëse ato dërgohen me shkrim në:

Misioni i Shqipërisë pranë Komuniteteve Europiane, Rue Hottat 42
B-Bruxelles
Belgium

Tel: (32) 2 6403544
Fax: (32) 2 3403177

Të gjitha njoftimet e dhëna nga Agjenti prezumohet të jenë dhënë për dhe në emër të Huamarrësit, dhe Huamarrësi do të detyrohet njëllë sikur t’i kishte bërë vetë këto njoftime.

Të gjitha njoftimet do të bëhen me anë të postës së regjistruar, nëse është e praktikueshme. Në rast të kundërt dhe në rast urgjence, ato mund të bëhen me fax, telex, swift ose nëpërmjet letrës së dorëzuar në

dorë në adresat e mësipërme dhe të konfirmuara nga posta e regjistruar nëse është e praktikueshme.

Të gjitha dokumentet, informacionet dhe materialet që do të jepen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze ose në gjuhën e vendit të Huamarrësit të shoqëruar nga një përkthim i vërtetuar në anglisht, duke mundësuar që, në rastin e dytë, përkthimi në anglisht do të jetë versioni mbi të cilin Huadhënësi do të ketë të drejtë të bazohet.

Neni 10 Të ndryshme

1. Nëse një ose më shumë dispozita të përfshira në këtë Marrëveshjeje do të jenë ose do të bëhen plotësisht të pavlefshme ose pjesërisht të paligjshme, ose të pazbatueshme në lidhje me çdo ligj të zbatueshëm, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera, pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje nuk do të ndikohet ose dëmtohet në asnjë mënyrë për këtë shkak. Dispozitat të cilat janë plotësisht ose pjesërisht të pavlefshme, të paligjshme ose të pazbatueshme, do të zbatohen sipas frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Preambula, vendimi dhe anekset e hyra në fuqi në vijim në lidhje me këtë Marrëveshje, p.sh. kontratat e huasë dhe siç mund të jetë rasti i një ose më shumë marrëveshjeje shpërndarjeje ose marrëveshjeje pajtimi, marrëveshjeje agjencie, ose marrëveshjeje agjencie fiskale, marrëveshjeje reklamë dhe marrëveshjeje shkëmbimi do të formojnë në vijim një pjesë integrale të Marrëveshjes. Titujt dhe nenet e Marrëveshjes janë vetëm për lehtësi referimi.

3. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është përcaktimi i kushteve dhe termave mbi bazën e të cilave KE-ja bën të disponueshme për Huamarrësin shumat përkatëse të transaksionit financiar përkatës, të caktuara nga KE-ja për këtë efekt. Për rrjedhojë, Huamarrësi dhe KE-ja pranojnë që të drejtat dhe detyrimet e tyre, përveçse ku parashikohet ndryshe nga Marrëveshja, janë të përcaktuara dhe të interpretuara duke iu referuar dokumentacionit përkatës së huasë. Në veçanti, kushtet e kontratave të huasë do të zbatohen në këtë Marrëveshje. Megjithatë, nëse ka një konflikt ndërmjet termave të kësaj Marrëveshjeje dhe ndonjë kontrate huamarrjeje, do të mbizotërojnë termat e kësaj Marrëveshjeje.

4. Një “ditë-punë” do të jetë një ditë në të cilën bankat në përgjithësi janë të hapura për aktivitet në vendet përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11 Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni

1. Kjo Marrëveshjeje i nënshtrohet dhe do të interpretohet në përputhje me ligjin anglez.

2. Palët zotohen të paraqesin, në vijim të nenit 238 të traktatit themelues të Komunitetit European (Traktati BE), çdo mosmarrëveshjeje lidhur me ligjshmërinë, vlefshmërinë, interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjejeje në juridiksionin dhe gjykimin nga Gjykata e Shkallës së Parë të Komuniteteve Europiane (GJSHP) me të drejtë apelimi te Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane (GJED), përcaktuar në nenin 225 të Traktatit të BE-së.

Gjykimet e GJSHP-së dhe GJED-it, sikurse mund të jetë rasti, do të jenë plotësisht të detyrueshme dhe të zbatueshme nga palët, me përjashtim kur është në gjykim një ankim nga GJSHP-ja dhe GJED-i, në mënyrë të përkohshme, pezullon veprimin e një gjykimi ose të çdo pjese të një gjykimi të GJSHP-së dhe në rastin e Komunitetit European, pa cenuar zbatimin e protokollit për privilegjet dhe imunitetet e Komuniteteve Europiane.

3. Huadhënësi mund të zbatojë çdo vendim të marrë të GJSHP-ja ose GJED-i, ashtu siç parashikohet në këtë Marrëveshjeje ose të drejta të tjera, ndaj Huamarrësit në gjykatën e vendit të Huamarrësit.

4. Nëpërmjet kësaj, Huamarrësi zotohet, në mënyrë të parevokueshme dhe të pakushtëzuar (1), të heqë dorë nga çdo imunitet që mund të ketë ose mund të fitojë nga juridiksioni dhe ekzekutimi në lidhje me çdo veprim ose procedim të kërkuar në GJED ose GJSHP, ose në gjykatat e vendit të Huamarrësit në lidhje me Marrëveshjen dhe (2) të ekzekutojë me kujdes dhe me mirëbesim çdo vendim që rrjedh nga ndonjë procedim ligjor i ndërmarrë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12 Hyrja në fuqi

Në vijim të ekzekutimit të saj, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën në të cilën Huadhënësi ka marrë një njoftim zyrtar nga Huamarrësi që të gjitha kërkesat kushtetuese dhe ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe zotimi i vlefshëm dhe i parevokueshëm i Huamarrësit për të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo Marrëveshje janë plotësuar.

Hyrja në fuqi nuk do të jetë më vonë se 6 gushti 2006. Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi brenda kësaj date, Palët e kësaj Marrëveshjeje nuk do të detyrohen më nga kjo Marrëveshje.

Neni 13

1. Dokumentet e mëposhtme i bashkëngjiten kësaj dhe janë pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

Bashkëlidhur 1: Kontratat huamarrëse

Bashkëlidhur 2: Memorandumi i mirëkuptimit

2. Kjo Marrëveshje do të hartohet nga secila Palë në katër kopje origjinale në gjuhën angleze dhe çdonjëra do të konsiderohet si instrument origjinal.

Bërë në Bruksel më 31 maj 2005 dhe në Tiranë 17 maj 2005 në katër kopje origjinale në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të Shqipërisë
Si Huamarrës
Nga Arben Malaj
Ministër i Financave i Shqipërisë
Banka e Shqipërisë
Si Agjent
Nga Ardian Fullani
Guvernator

Nënshkruar për dhe në emër të Komunitetit
Europian
Përfaqësuar nga Komisioni i Komuniteteve
Europiane
Si Huadhënës
Nga Joaquin Almunia
Anëtar i Komisionit

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Në 29 prill 2004, Këshilli i Komunitetit Europian miratoi një vendim për të bërë të vlefshme për Republikën e Shqipërisë (që tani e tutje referohet si “Vendi”) një asistencë makrofinanciare deri në 25 milionë euro, e përbërë nga një lehtësirë huaje deri në 9 milionë euro (huaja) dhe një lehtësirë granti deri në 16 milionë euro (Granti) (vendimi 2004/580/KE). Objektivi i kësaj asistence është të zbusë vështirësitë e financimeve të huaja të vendit, të mbështesë bilancin e pagesave dhe të fuqizojë pozicionin e rezervave të këmbimit të huaj. Asistenca nga Komuniteti Europian është plotësues i burimeve të siguruara për Vandin nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët bilateralë në mbështetje të stabilizimit ekonomik të autoriteteve dhe programit të reformave.

2. Asistenca do të disbursohet në të paktën dy këste. Disbursimi i asistencës do të kushtëzohet nga ecuria e pëlqyeshme në zbatimin e marrëveshjes aktuale ose marrëveshjeve pasuese të rëna dakord ndërmjet Vendit dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), si dhe nga vlerësimi pozitiv nga Komisioni Europian (që tani e tutje i referohet si “Komisioni”), në emër të Komunitetit Europian, nga ecuria e bërë në lidhje me stabilizimin ekonomik dhe reformat strukturore.

Kushtet makroekonomike dhe politika e rregullimeve strukturore të bashkëngjitura kësaj asistence bazohen në stabilizimin ekonomik dhe programin e reformave të nënshkruara nga autoritetet e vendit dhe që janë në përputhje me marrëveshjet e arritura nga vendi me FMN-në.

Kriteret sasiore të performancës bashkëngjitur asistencës së Komunitetit do të jenë ato të specifikuar në Marrëveshjen aktuale për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike ose në marrëveshje pasuese të rëna dakord ndërmjet Vendit dhe FMN-së. Përpara disbursimit të çdo kësti të kësaj asistence, Komisioni, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe stafin e FMN-së, do të verifikojnë se kriteret sasiore të performancës janë respektuar siç duhet ose është rënë dakord për kuptime të reja. Kriteret aktuale sasiore përmbajnë:

i) kufij tremujorë për aktivet neto të brendshme të Bankës së Shqipërisë (BSH);

ii) kufij tremujorë për kredinë neto të sistemit bankar për qeverinë qendrore të konsoliduar;

iii) objektiva treguese tremujore të të ardhurave totale nga taksat;
iv) tavanë tremujorë për rezervat neto ndërkombëtare të BSH-së;
v) kufij tremujorë për kontraktimin ose garantimin e borxhit të jashtëm publik jokoncesional dhe publik i garantuar.

3. Për shumat e sakta dhe kohën e disbursimit të secilës transhe do të bihet dakord nga të dyja palët në kuadër të Grantit dhe/ose marrëveshjeve të huasë. Disbursimi i dytë dhe këstet e mëpasme nuk do të bëhen përpara të paktën tre muaj pas disbursimit të kështit të mëparshëm.

Në përcaktimin e shumave që do të disbursohen nga kjo asistencë, do të merret në konsideratë mobilizimi i efektshëm i asistencës financiare ndaj vendit nga donatorë të tjerë dhe ecuria e nevojave financiare.

Pas marrjes së njoftimeve të përputhshmërisë nga autoritetet e Vendit dhe përpara pagesës së çdo kësti, Komisioni do të vlerësojë, në bashkëpunim me autoritetet e Vendit, ecurinë e bërë lidhur me përbushjen e kriterëve sasiore të performancës dhe një numër të përzgjedhur të kriterëve të reformave strukturore. Në këtë vlerësim, vëmendje e veçantë do t'i jepet reformës së financave publike dhe administrimit, reformave në sektorin bankar dhe zhvillimin e sektorit privat. Kuadri referues për këtë vlerësim jepet shprehimisht në shtojcën I. Mund të rregullohet në një fazë të mëvonshme.

4. Pagesa e efektshme e kësteve të ndryshme do të jetë subjekt i nënshkrimit të angazhimeve ligjore përkatëse (Marrëveshje granti/huaje) nga palët. Këstet e grantit do të jenë subjekt i vendimit të autoritetit buxhetor të KE-së për të bërë të vlefshme shumat e nevojshme.

5. Komisioni do të bëjë të vlefshme shumat e huasë dhe grantit të Banka e Shqipërisë (BSH) që vepron si agjent i Vendit ose tek institucioni ose institucionet e caktuara për të marrë përgjegjësinë nga BSH-ja për marrjen e fondeve në kontekstin e kësaj asistencë makro-financiare komunitare.

Autoritetet e Vendit marrin përsipër të përbushin në kohën e duhur dhe plotësisht të gjitha detyrimet financiare që burojnë nga huatë e siguruara ose të garantuara nga Komuniteti European.

Gjatë zbatimit të asistencës, autoritetet e Vendit do t'i sigurojnë Komisionit të gjithë informacionin përkatës, lidhur me monitorimin e situatës financiare dhe ekonomike dhe që do të jetë e nevojshme për vlerësimin e kriterëve sasiore të performancës dhe për rishikimin e ecurisë së reformave strukturore. Në veçanti, autoritetet do t'i japin Komisionit, mbi baza tremujore, informacionin përkatës siç përcaktohet në shtojcën II.

6. Komisioni, i përfaqësuar nga agjentët e tij ose ekspertët e duhur të mandatuar do të kenë të drejtën të kryejnë vlerësimet operative të procedurave administrative dhe të rrjetit financiar të Vendit dhe të agjentit lidhur me menaxhimin e asistencës makrofinanciare komunitare.

7. Një vlerësim i pavarur *ex-post* i asistencës mund të kryhet nga Komisioni ose përfaqësuesit e duhur të autorizuar. Autoritetet e Vendit janë të angazhuar të japin të gjithë informacionin e nevojshëm sipas rastit. Raporti i vlerësimit do të bëhet i vlefshëm për ta për komente.

8. Autoritetet do të sigurojnë, në mënyrë të duhur, bashkëpunim të ngushtë me Komisionin European.

9. Asistenca zbatohet me kuptimin që autoritetet e Vendit do të vazhdojnë të respektojnë rregullën e ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

10. Sipas vendimit të Këshillit të KE/2004/580 të 29 prillit 2004, kjo asistencë do të zbatohet deri në 6 gusht 2006.

11. Shtojcat I dhe II janë pjesë përbërëse e këtij memorandum.

12. Të gjitha njoftimet lidhur me memorandumin aktual do të jepen me shkrim dhe dërgohen te:

Për Komunitetin European

Komisioni i Komunitetit European
Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Financiare dhe Ekonomike
Rue de la Loi, 200-bu-1 1/57, b-1049 Bruksel
Nr.faksi (+32-2)299 61 51

Për Vendin

Ministri i Financave
Arben Malaj
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Nr.faksi: +355 4 22 8494

Për Bankën Kombëtare të Vendit

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" nr.1
Nr.faksi +355 4 22 3558

Bërë në Bruksel në gjuhën angleze _____ 2005 dhe në Tiranë në _____ 2005 në katër kopje origjinale.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Përfaqësuar nga

Arben Malaj
Ministër i Financave

KOMUNITETI EUROPIAN
Përfaqësuar nga

Joaquin Almunia
Anëtar i Komisionit Europian

GUVERNATORI I BANKËS SË SHQIPËRISË
Ardian Fullani
Guvernator i Bankës së Shqipërisë

SHTOJCA I KRITERET E REFORMAVE STRUKTURE

1. Veprimet për t'u ndërmarrë nga Ministria e Financave përpara disbursimit të kështit të parë për të thelluar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit financiar dhe kontrolleve administrative.

- Për thesarin, qartësimi dhe formalizimi i delegimit të autoritetit nga niveli (niveli i cili mund të kërkojë, miratojë, urdhërojë, marrë, paguajë, rakordojë, për cilën lloj shpenzimesh, deri në cilën shumë) dhe të sigurojë ndarjen e duhur të detyrave. Staf i cili kryen pagesat nuk do të ketë detyrë për të miratuar pagesat ose rakorduar shumat.

- Të zbatojë firmosjen e dyfishtë të pagesave nga thesari.

2. Në kohën kur Komisioni rishikon se do t'i paraprijë vendimit lidhur me disbursimin e kështit të dytë, autoritetet janë të angazhuara të kenë arritur ecuri në fushat e mëposhtme:

Masat për të thelluar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit financiar dhe kontrolleve administrative dhe për të përmirësuar menaxhimin e financave publike.

- Dërgim tremujor nga Ministria e Financave te Këshilli i Ministrave të raporteve të auditit të brendshëm të ministrive të linjës, së bashku me rekomandimet për rregullimin e veprimeve në fushat e identifikuar.

- Miratim i letërpolitikës për kontrollin e brendshëm të financave publike.

- Ecuri në futjen e sistemit të ri të integruar të IT për të mbështetur aktivitetet bazë të thesarit. Në veçanti, fillimi i operacionit të trefishtë në distriktin e Tiranës.

Masat për të përmirësuar funksionimin e administratës publike dhe luftës kundër korrupsionit.

- Procedimi i pagesës në të paktën 50% të pagave të sektorit publik nëpërmjet sistemit bankar.

- Miratimi* i kuadrit ligjor mbi konfliktin e interesave.

- Miratimi i masave ligjore për të kufizuar vonesat në procesin gjyqësor.

Reforma e sektorit financiar

- Miratimi i ligjit të ri për sektorin bankar.

- Futja te Banka e Shqipërisë e një sistemi *software* të integruar dhe zbatimi gjatë gjithë vitit 2005 i planit të mbikëqyrjes bankare.

- Miratimi i akteve nënligjore për sigurimet/risigurimet, përfshirë rregulla të kujdesshme lidhur me risigurimin.

Masat për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të përsheptuar zhvillimin e sektorit privat.

- Miratimi i planit të ri të veprimeve mbi heqjen e barrierave administrative.

- Miratimi i ligjit të ri mbi regjistrimin tregtar me qëllimin e lehtësimit të futjes në treg.

- Ofrimi për shitje (tenderi përfundimtar) i Albtelekomit dhe ARMO-s.

* "Miratimi" duhet të kuptohet në shtojcën aktuale si "Miratim qeveritar"

SHTOJCA II SISTEMI I MONITORIMIT

Gjatë zbatimit të asistencës komunitare, treguesit në vijim dhe raportet do të bëhen të vlefshme për Komisionin nga autoritetet përkatëse mbi baza tremujore.

1. Monitorimi i zhvillimeve makroekonomike dhe financiare, dhe politikave
 - PBB ose të ardhurat kombëtare (të dhëna vjetore ose tremujore kur të jenë të vlefshme).
 - Komponentët kryesorë të PBB (të dhëna vjetore)
 - Prodhimi industrial (mujor)
 - Pagat mujore
 - Përqindja e punësimit dhe e papunësisë (mujore)
 - Treguesit e çmimeve (mujorë)
 - Normat e interesave afatshkurtra (mujore)
 - Niveli dhe përbërja e të ardhurave qeveritare dhe shpenzimeve, si dhe detyrimeve të prapambetura qeveritare (niveli i qeverisjes qendrore, mujore)
 - Tregtia e jashtme (mujore)
 - Bilanci i pagesave (tremujor)
 - Pozicioni i rezervave ndërkombëtare (mujore)
 - Kurset e këmbimit valutor (javore)
 - Borxhi i jashtëm (tremujor) përfshirë detyrimet e prapambetura të jashtme (tremujore)
 - Pagesat e shërbimit të borxhit (tremujore)
2. Monitorimi i politikave strukturore:
 - Raport progresi i reformës së financave publike dhe administrative;
 - Raport progresi i reformës në sistemin bankar;
 - Raport progresi i zhvillimit të sektorit privat.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njërive postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 24.10.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë